



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.12.2019, ora 08:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtim i projektrezolutës “Për ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Lefter Maliqi, Alban Zeneli, Edmond Rrushi, Ylli Shehu, Arben Elezi, Elona Gjebrea, Luan Duzha, Anduel Xhindi, Myslym Murrizi, Nimet Musaj, Arlind Çaçani, Luan Harusha, Paulin Sterkaj dhe Elena Xhina.

Mungojnë:

Të ftuar:

Ervin Bushati – Deputet, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Ju kërkoj ndjesë që ju detyrova t'ju nxjerr herët, por siç e bëra sqarimin edhe në grup, koha është pak e kufizuar dhe na ka ngelur vetëm një seancë plenare për të zhvilluar dhe e mbyllim për këtë sesion parlamentar, për të filluar në javën e tretë të janarit!

Kishim lënë miratimin në tërësi të rezolutës, por mbasi lamë një detyrë në mbledhjen e fundit të Komisionit të Sigurisë, që propozuesit e draftrezolutës, kolegu ynë Ervin Bushati dhe kryetari i grupit, zoti Taulant Balla, të mund të reflektonin disa nga amendimet e propozuara edhe në mënyrë formale nga kolegu tjetër Ditmir Bushati, si dhe diskutimet që u mbajtën atë ditë gjatë komisionit.

Kështu që, për të na thënë diçka më tepër rreth azhurnimeve të fundit të draftrezolutës, do t'ia jap fjalën zotit Bushati.

Ervin Bushati – Mirëmëngjesi!

Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, të nderuar deputetë!

Në fakt, mbas diskutimit dhe votimit në parim që patëm në Komisionin e Sigurisë dhe mbas diskutimit në Komisionin e Jashtëm, si komision për dhënie mendimi, propozimet apo sugjerimet e Komisionit të Jashtëm, të cilat erdhën me shkrim, si dhe propozimet e deputetit Ditmir Bushati, janë referuar, le të themi, edhe në trupin e rezolutës, por edhe në pika të veçanta.

Kështu që janë përmendur Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia e Mbrojtjes Kibernetike, Agjenda Digjitale e Shqipërisë, Dokumenti i Politikave për Sigurimin Kibernetik 2015-2017. Janë përmendur dhe referuar sipas pikave të Kushtetutës, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, ligji nr.2/2017 “Për sigurinë kibernetike”, rezoluta e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës nr.4255 dhe është marrë në konsideratë rezoluta e miratuar nga Parlamenti Europian më 10 tetor 2019.

Të gjitha këto referenca janë në rezolutën përfundimtare, që ju e keni mbi tavolinë. Janë referuar edhe në trupin e gjithë rezolutës referencat, pra *footnotes*. I keni në fund keni të gjitha referencat që merren nga këto rezoluta që përmenda më sipër.

Në këndvështrimin tonë rezoluta është e plotë. Në koherencën logjike i ka qëndruar misionit të saj të parë për të adaptuar rezolutën e Parlamentit Europian të datës 10 tetor 2019.

Gjithashtu, janë referuar të gjitha bazat kushtetuese ligjore të Republikës së Shqipërisë, sipas asaj që ne morën parasysh.

Kështu që shpresoj se kolegët e Komsionit të Sigurisë do ta mbështesin rezolutën në tërësi dhe pikë për pikë, ashtu siç është dorëzuar në dokumentin që ju keni, ku janë parashikuar edhe sugjerimet me shkrim të Komisionit të Jashtëm, edhe amendimet e deputetit Bushatit të përfshira në trup, të akorduara dhe të harmonizuara me trupin, për të mos lëvizur nga koherenca e saj, si në logjikë, ashtu edhe në vijimësi strukturore.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Bushati!

Ne e diskutuam edhe gjatë mbledhjes së Komisionit të Sigurisë Kombëtare që ishte e nevojshme që baza mbështetëse e kësaj draftrezolute të plotësohej, ashtu sikundër në të njëjtën kohë ishte propozuar edhe nga kolegu tjetër Bushati në Komisionin e Politikës së Jashtme.

Nuk e di nëse ka ndonjë pyetje nga kolegët apo ndonjë sqarim. Nuk ka.

Atëherë kalojmë në votim.

Kush është dakord me miratimin e projektrezolutës “Për ndërhyrjet e huaja në proceset zgjedhore dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare”?

Kundër nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Ju faleminderit!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA